KONTABILITETI

Mësimdhënës: **Ylber PREKAZI**

4. Procesi i regjistrimit kontabël. Sistemi i regjistrimit të dyfishtë.

- Sistemi i regjistrimit të dyfishtë si metodë bazë e kontabilitetit;
- Dokumentet burimore për regjistrimin e veprimeve;
- Llogaria (Konto). Ditari. Libri kryesor (i madh). Bilanci vërtetues;

Sistemi i regjistrimit të dyfishtë si metodë bazë e kontabilitetit

- **Kontabiliteti,** për regjistrimin e efekteve të veprimeve ekonomike në llogari të veçanta, përdor **metodën e regjistrimit të dyfishtë.**
- Sipas parimit të **dualitetit**: që nënkupton se të gjitha veprimet ekonomike kanë dy aspekte: ***sakrificën dhe përfitimin, përpjekjen dhe shpërblimin, burimin dhe përdorimin - të cilat kompensojnë apo balancojnë njëra tjetrën.***
- Sipas kësaj metode në kontabilitet çdo veprim ekonomik ***duhet të pasqyrohet të paktën në debi të një llogarie dhe në kredi të një llogarie tjetër me shuma patjtër të barabarta.***

Sistemi i regjistrimit të dyfishtë si metodë bazë e kontabilitetit...*vazhdim*

- **Principet kryesore të sistemit të regjistrimit të dyfishtë janë:**
  - *Çdo fakt në njësinë ekonomike ekzaminohet nën dy aspkete;*
  - *Për çdo aspekt çelet një seri llogarish;*
  - *Çdo llogari ka dy anë që shërbejnë për regjistrimin e ndryshimeve në rritje dhe zvogëlim;*
  - *Në të dyja seritë e llogarive variacionet regjistrohen në kahe të kundërta (p.sh. Ndryshimet në rritje të aktiveve në DEBI, ndryshimet në rritje të pasiveve në KREDI);*
  - *Njësia matëse monetare në llogari duhet të jetë unike;*
  - *Duhet patjetër që për çdo fakt të regjistruar të ketë një barazi midis debitimeve dhe kreditimeve;*

Dokumentet burimore për regjistrimin e veprimeve

- Veprimet ekonomike që kryhen në njësinë eonomike bazohen në dokumentet fillestare (psh. faturat, madatpagesat, madatarkëtimet, çeqe);
- Çdo veprim ekonomik duhet të regjistrohet bazuar gjithmonë në dokumentet që vertetojnë kryerjen e tij;
- Dokumentet duhet të kenë një informacion të mjaftueshëm për të treguar se çfarë veprimi është kryer, kur është kryer, personat e përfshirë në këtë veprim si dhe shumën e veprimit.
- Në Kosovë, ligji për kontabilitetin parashikon një periudhë prej 6 vjetësh që të ruhen dokumentet kontabël në bazë të të cilave janë kryer regjistrimet (në Shqipëri 10 vite);

Llogaria (konto)

Emri i llogarisë

(ana e majtë)	(ana e djathtë)
DEBI	**KREDI**

Emri i llogarisë

DATA		Përshkrimi	Ref.	Shuma DEBI	DATA		Përshkrimi	Ref.	Shuma KREDI
Muaji	Viti				Muaji	Viti			

DEBITI dhe KREDITI



7

Forma e zgjeruar e ekuacionit bazik kontabël



8

Ditari

- Për të siguruar **regjistrime kronologjike** të të gjitha veprimeve ekonomike të njësisë përdoret një libër kontabël i veçantë që quhet ***ditar***.

DITARI

Data	Përshkrimi	Ref.	Shuma	
			Debi	Kredi

Libri kryesor (i madh)



Bilanci vërtetues

- Për efekte të saktësisë së bartjes së veprimeve nga ditari në librin e llogarive, përdoret një pasqyrë e posaçme kontabiliteti e quajtur ***bilanc vërtetues.***
- Bilanci vërtetues është lista e të gjitha llogarive, të përdorura në një njësi ekonomike, me lëvizjet dhe tepricat e tyre.

BILANCI VËRTETUES

Nr	Emërtimi i llogarive	Teprica	
		Debi	Kredi

Transaksioni 1

- Më 1 mars 2007 Ermal Brovina ka filluar punën në një firmë të regjistruar si agjencion "Brovina Tours". Në këtë datë ai ka hapur llogari bankare për firmën e tij dhe fillimisht ka deponuar 70.000 €.
- Analiza:
  - Është rritur llogaria e pasurisë, **paraja e gatshme**. Gjithashtu është rritur një llogari e kapitalit, **kapitali i pronarit Brovina**.
  - Konform rregullave të debitit dhe kreditit: Rritjet e pasurisë regjistrohen në Debi, kurse rritjet e kapitalit regjistrohen në Kredi.
  - Regjistrimi i transaksionit:

Paraja e gatshme	
1) 70.000	

Kapitali i "Brovina Tours"	
	1) 70.000

12

Transaksioni 2

- Më 2 mars "Brovina Tours" ka blerë një lokal për zyre në Gjakovë, në vlerë prej 30.000 € me afat pagese (kredit) 2 muaj.
- Analiza:
  - Është rritur llogaria e pasurisë, **ndërtesat**. Gjithashtu është rritur një llogari e detyrimeve, **llogaria e pagueshme**.
  - Konform rregullave të debitit dhe kreditit: Rritjet e pasurisë regjistrohen në Debi, kurse rritjet e detyrimeve regjistrohen në Kredi.
  - Regjistrimi i transaksionit:

Ndërtesat	
2) 30.000	

Llogaria e pagueshme	
	2) 30.000

13

Transaksioni 3

- Më 3 mars "Brovina Tours" ka blerë mobilje dhe pajisje të tjera për zyre, në vlerë prej 15.000 € me para të gatshme.
- Analiza:
  - Është rritur llogaria e pasurisë, **pajisjet**. Njëkohësisht është zvogëluar një llogari e pasurisë, **paraja e gatshme**.
  - Konform rregullave të debitit dhe kreditit: Rritjet e pasurisë regjistrohen në Debi, kurse zvogëlimet e pasurisë regjistrohen në Kredi.
  - Regjistrimi i transaksionit:

Pajisjet	
3) 15.000	

Paraja e gatshme	
1) 70.000	3) 15.000

14

Transaksioni 4

- Më 4 mars "Brovina Tours" ka shitur bileta dhe shërbime për 6.000 €. Nga këto shërbime të shitura për 1.000 € është pranuar paraja e gatshme, kurse të tjerat janë shitur me afat pagese (kredit) për një muaj.
- Analiza:
  - Është rritur llogaria e pasurisë, **paraja e gatshme,** për shumën e arkëtuar, dhe është rritur llogaria e pasurisë së blerësit, për shumën e shitur të shërbimëve me afat pagese. Gjithashtu është rritur një nënllogari e kapitalit, është rritur llogaria e **të hyrave**.
  - Konform rregullave të debitit dhe kreditit: Rritjet e pasurisë regjistrohen në Debi, kurse rritjet e të hyrave regjistrohen në Kredi.
  - Regjistrimi i transaksionit:

Paraja e gatshme	
1) 70.000	3) 15.000
4) 1.000	

Llog arkëtueshme (blers)	
4) 5.000	

Të hyrat	
	4) 6.000

15

Transaksioni: **5)** Më 5 mars firma ka blerë me para të gatshme në vlerë 1.200 € një aparat të fotokopjes.

Transaksioni: **6)** Më 27 mars firma ka përmbushur me para të gatshme detyrimin ndaj furnitorit lidhur me mobiljet e blera më parë në vlerë prej 15.000 €.

Transaksioni: **7)** Më 29 mars "Brovina Tours" ka paguar me para të gatshme këto shpenzime operative: 300 € për shpenzime të rrymës, 1.200 € për paga dhe 100 € për shpenzime të ujit.

Transaksioni: **8)** Më 29 mars firma ka përmbushur me para të gatshme detyrimin ndaj furnitorit lidhur me ndërtesat e blera më parë në vlerë prej 14.000 €.

Transaksioni: **9)** më 31 mars pronari i "Brovina Tours" ka tërhequr prej firmës, për nevoja personale 200 €, para të gatshme.

16

DITARI				
Data	Emri i llogarisë dhe përshkrimi	Ref.	DEBI	KREDI
01.03.2013	Paraja e gatshme Kapitali i pronarit Investimet fillestare të pronarit		70000	70000